



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË LIPJANIT  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit, Ramadan Gashi dhe Qëndresa Sogojeva, anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Florim Beqiri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	23
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	24
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	27
Shtojca IV: Letër konfirmimi .....	31

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Lipjanit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 28.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Për më hollësisht, shih Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksimi i çështjes

Si Theksim i Çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se ishin bërë pagesa të parregullta për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve në vlerë 13,012€, për faktin se kontrata kornizë e nënshkruar për 36 muaj kishte skaduar dhe ishte vazhduar me vendim të drejtorit të prokurimit.

Po ashtu, llogaritë e arktuëshme ishin nënvlerësuar për 255,970€ në PFV.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:

Për shkak të rëndësisë së informatës lidhur me pagesat e parregullta dhe, nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, të njëjtat janë theksuar tek opinioni i auditimit.



Kryetari duhet të analizoj arsyet për Theksimin e Çështjes në 2016 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë të informatave në PFV e vitit 2017 (shih nënkapitulli 1.1).

Komuna nuk i kishte zbatuar në shkallën e duhur rekomandimet e vitit të kaluar.



Kryetari duhet të siguroj se plani i veprimit po zbatohet në mënyrë rigorozë, me fokus të veçantë tek çështjet e identifikuara me prioritet të lartë. Progresi në këtë fushë, duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari. (shih çështjet 1).

Komuna ka hartuar një numër të dokumenteve strategjike, mirëpo nuk kishte bërë monitorimin e tyre për të ndërlidhë objektivat me rezultatet.



Kryetari duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin sistematik të arritjes së objektivave strategjike duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes (shih çështjet 3).

Pasqyra e shpenzimeve të fondeve, nxjerrë në pah një nivel relativisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitale (86%).



Kryetari të siguroj se me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i buxhetit për të siguruar përmirësim në ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale për vitin 2017 (shih çështjet 5).

Menaxhimi i të hyrave vetjake, prokurimi, subvencionet, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme janë fusha që ende kërkojnë përmirësim.



Kryetari duhet ta aplikoj një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 6-15).

---

## Përgjigja e Menaxhmenti në auditimin e vitit 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna. Ne konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV të komunës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të PFV-ve.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

---

## **Baza për opinion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj se komuna kishte bërë pagesa të parregullta në vlerë 13,012€ për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve për faktin se kontrata kornizë e nënshkruar për 36 muaj kishte skaduar dhe ishte vazhduar me vendim të drejtorit të prokurimit. Sipas nenit 38.2 të Ligjit të Prokurimit Publik, asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ripërtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.

Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme nga të hyrat e shpronësimit për pronat komunale ishin nënvlerësuar për 255,970€ për shkak se komuna nuk i kishte prezantuar në PFV.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se PFV nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

---

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e PFV nga komuna, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e komunës, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PFV.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2016; dhe
- PVF janë përgatitur me kohe dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Nga aspekti i prezantimit të cilësisë së informatave në PFV, përveç çështjeve të përmendura të nënkapitulli 1.1 Opinioni i auditimit nuk kemi hasur në ndonjë çështje tjetër të rëndësishme për raport.

### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit të cilat ne i kemi konsideruar jo materiale.



---

## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime.

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes për një komunë janë thelbësore që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon përkushtimin e menaxhmentit në përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Kontrollet e vendosura nga komuna në përgjithësi kanë funksionuar mirëpo, ekziston ende hapësirë për t'u përmirësuar aspekti i qeverisjes, veçanërisht në lidhje me monitorimin e strategjive, menaxhimin e rrezikut dhe adresimin e rekomandimeve.

Po ashtu, në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve përkatëse auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë prokurimin, të hyrat dhe subvencionet.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015, ka rezultuar me 12 rekomandime, nga të cilat 10 ishin me prioritet të lartë dhe 2 me prioritet të mesëm. Komuna kishte zbatuar kërkesën për të përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për PFV për vitin 2015 të ZKA-së, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Raporti i auditimit për PFV e vitit 2015 ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal me procesverbalin e datës 05.09.2016.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, një (1) rekomandim me prioritet të lartë është zbatuar, shtatë (7) rekomandime janë në proces të zbatimit (5 me prioritet të lartë dhe 2 të mesëm) dhe katër (4) rekomandime me prioritet të lartë nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

### Çështja 1 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna kishte angazhuar auditorin e brendshëm për ta përcjellë zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar të dhëna nga ZKA, dhe kjo njësi e ka bërë rishikimin e rekomandimeve dhe ka prezantuar gjendjen aktuale dhe progresin e arritur, mirëpo nuk ishte kritike në vlerësimin e shkaqeve dhe arsyeve për ngecjet në këtë fushë.

Ne kemi vërejtur se komuna ka një ngecje të theksuar në zbatimin e rekomandimeve. Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprime të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e plotë të tyre. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësimet e vazhdueshme në komunë.

**Rreziku** Disa rekomandime po përsëriten nga viti i kaluar që tregojnë për dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sisteme kryesore financiare që kanë rezultuar me:

- Dobësitë në prokurim;
- Dobësi në menaxhimin e të hyrave vetjake; dhe
- Nënvlërim të llogarive të arkëtueshmëve.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të siguroj se plani i veprimit po zbatohet me kohë për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me një rëndësi më të madhe, duke marr veprime aktive në zbatimin e plotë të tyre. Progresi duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.

## 2.2 Pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Konkluzionet tona nuk kanë për qëllim të komentojnë cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 2- Pyetëtori i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

Komuna ka hartuar listën e rreziqeve si dhe strategjinë gjithëpërfshirëse në të cilën parashihen kostot e strategjisë, mirëpo nuk kishte bërë monitorim që i ndërlihdë objektivat e me rezultatet.

**Rreziku** Mungesa e monitorimit të strategjisë dhe listës së rreziqeve rritë rrezikun që objektivat e përcaktuara të komunës të devijojnë nga plani fillestar dhe të mos arrihen.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj që të delegohet përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet. Të bëhet monitorimi i strategjisë për t'u sigurua se janë duke u arritur objektivat.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna ka hartuar disa dokumente strategjike, si; Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2012-2017, Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023, Plani Zhvillimore Urban 2013-2018, Planin Operativ dhe Emergjent, dhe Plani i Veprimtimit Kundër Korrupsionit 2016-2019.

---

### Çështja 3 - Dokumentet strategjike - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna ka hartuar një numër të dokumenteve strategjike, duke përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planeve strategjike, mirëpo mungon një monitorim konkret nga menaxhmenti dhe raportimi në periudha të caktuara kohore mbi zbatimin (realizmin) e tyre.
- Rreziku** Mos monitorimi i strategjisë bënë të pamundur që të përcillet përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin sistematik të arritjes së objektivave strategjike, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

#### 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Komuna i posedon raportet e rregullta mujore që bëhen nga drejtorët dhe zyrtarët kyç dhe dërgohen tek Kryetari. Përveç këtyre, komuna posedon raporte 3, 6, 9 mujore dhe raportin vjetor financiar që aprovohen në Kuvendin e Komunës, si dhe raportin tremujor dhe vjetor mbi progresin e investimeve kapitale, si kërkesë e veçantë ligjore.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna e ka të themeluar NJAB e cila funksionon me dy auditorë, njëri prej tyre drejtor i NJAB.

Njab kishte hartuar dhe aprovuar planin strategjik (2016/2018) si dhe planin vjetor të auditimit.

Njab për vitin 2016 ka planifikuar dhe kryer shtatë (7) auditime të rregullta. Raportet janë përfunduar me kohë dhe si fusha rishikimi ishin përzgjedhur: (1) Menaxhimi i Prokurimit, viti 2015; (2) Të hyrat e tatimit në pronë, viti 2015; (3) Të hyrat në drejtorinë për planifikim dhe urbanizëm, periudha janar 2015/prill 2016); (4) Shpenzimet për mallra dhe shërbime në shëndetësi, viti 2016; (5) Menaxhimi i automjeteve, periudha janar 2015/qershor 2016); (6) Shpenzimet në administratë, periudha janar 2015/shtator 2016); dhe (7) Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, viti 2016.

---

---

#### Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve të NjAB - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se menaxhmenti kishte bërë plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB për fushat e audituara, mirëpo zbatimi i tyre ishte i dobët. Nga 57 rekomandime të dhëna, 35 ishin zbatuar, ndërsa 22 nuk ishin zbatuar ende. Po ashtu, komiteti i auditimit ishte themeluar më 05.09.2014 dhe ishte takuar tri (3) herë, ku kishte komentuar gjetjet e auditimit, dhe kishte nxjerrë rekomandime dhe konkluzione për menaxhmentin se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret.
- Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna nga NJAB, rritë rrezikun që dobësitë e identifikuar të mos korrigjohen, dhe rekomandimet e njëjta të përsëriten. Mungesa e komunikimit të duhur të komitetit të auditimit me menaxhmentin, rrit rrezikun që menaxhmenti të mos jetë i informuar për të ndërmarrë masat adekuate për çështjet e ngritura nga auditimi.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. Komiteti i auditimit në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin II, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe të arkëtueshmet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi i të hyrave nga tatimi në pronë mbetet ende sfidë për komunën për shkak të borxheve të pambledhura si dhe mos verifikimin e 1/3 të pronës komunale, borxhet nga dhënia e pronës komunale me qira dhe borxhet ndaj furnitorëve. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë ekzekutimi i buxhetit, menaxhimi i shpenzimeve në investime kapitale dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,650,000	1,650,000	1,808,065	1,453,652	1,623,310

Në totalin (1,808,065€) e të hyrave vetjake të mbledhura janë të përfshirë, gjobat e gjykatave, të hyrat nga pyjet dhe dënimet e policisë (79,221€). Në vitin 2016, për 10% plani i të hyrave ishte tejkualuar 10%. Në këtë tejkualim ka ndikuar shumica e të hyrave prej 46,400€ të pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shpronësimin e tokës për ndërtimin e autostradës "Arbër Xhaferi".

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>13,048,839</b>	<b>13,810,740</b>	<b>13,172,294</b>	<b>13,399,034</b>	<b>12,035,270</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,398,839	11,519,824	11,503,444	11,231,064	11,011,614
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	-	540,718	453,645	970,102	353,095
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,650,000	1,650,000	1,137,530	943,666	664,950
Donacionet e brendshme	-	5,248	5,000	239	5,611
Donacionet e jashtme	-	94,950	72,675	253,963	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 761,900€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 120,984€, të hyrave të bartura prej 540,718€, si dhe donacioneve të brendshme 5,248€, dhe të jashtme me vlerë 94,950€.

Të hyrat e bartura nga viti 2015 ishin 540,718€, ku pjesa më e madhe ishte ndarë për investime kapitale (376,389€), mallra/shërbime dhe komunalit (145,876€), paga dhe mëditje (10,887€) dhe subvencionet (4,239€).

Një suficit komulativ prej 757,608€ i të hyrave vetjake nga viti 2016 dhe vitet të më hershme, është bartur në vitin 2017.

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpenzimi të hyrave në vitin 2016 ishte 68%, tregon se komuna nuk ka arritur të përfundoj projektet me të cilat ka planifikuar të realizoj nga burimet vetjake.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>13,048,839</b>	<b>13,810,740</b>	<b>13,172,294</b>	<b>13,399,034</b>	<b>12,035,270</b>
Pagat dhe Mëditjet	8,658,911	8,774,375	8,711,706	8,538,950	7,801,404
Mallrat dhe Shërbimet	782,630	928,927	881,580	1,097,284	935,196
Shërbimet komunale	198,390	191,287	179,045	223,976	236,323
Subvencionet dhe Transferet	329,067	381,718	375,763	204,972	203,584
Investimet Kapitale	3,079,841	3,534,433	3,024,200	3,333,852	2,858,763

Buxheti final për vitin 2016 ishte ekzekutuar në nivelin 95% të planifikimit. Kjo konsiderohet një performancë shumë e mirë e ekzekutimit buxhetor. Shkalla e ngjashme e ekzekutimit të buxhetit ishte edhe dy vitet e kaluara (96% në vitin 2015 dhe 91% në vitin 2014).

#### Çështja 5 - Ekzekutimi i buxhetit për shpenzime kapitale - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Pasqyra e shpenzimeve të fondeve, krahasuar me kategoritë tjera, nxjerrë në pah një nivel pak më të ultë të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale (86%). Kjo, për shkak të dështimeve në realizimin e projekteve kapitale sipas planeve dinamike.

**Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve financiare të komunës dhe në reduktimin e projekteve të planifikuara që të realizohen gjatë vitit.

**Rekomandimi 6** Kryetari të siguroj se me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i buxhetit për të siguruar përmirësimet e duhura në ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale për vitin 2017. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin 1,808,065€. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje në inkasimin e të hyrave për rreth 24%.

---

**Çështja 6 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Komuna nuk ka arrit të kryej verifikimit të 1/3 së pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën të paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Sipas zyrtarëve komunal, mos verifikimi i pronës ka ndodhur për shkak të mungesës të anketuesve në terren për verifikim të pronave.
- Rreziku** Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.
- Rekomandimi 7** Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart, Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me Udhëzimet administrative dhe ligjet.

**Çështja 7- Kontrolle të dobëta në qiradhëniet komunale - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Nga gjashtë (6) mostrat e testuara për pronat e dhëna me qira kemi vërejtur se katër (4) obligues nuk i kishin kryer obligimet ndaj komunës për pronën që shfrytëzojnë sipas kontratës. Obligimi për këta shfrytëzues ishte 38,168€. Menaxhmentit nuk kishte ndërmarr veprimet e duhura për t'i obliguar këta obligues që t'ju përmbahen kontratave të qirasë të lidhura me komunën. Edhe pse në dy raste komuna ju kishte shkëput kontratat qiramarrësit ata akoma shfrytëzojnë lokalet e komunës.
- Rreziku** Për shkak të praktikave jo efektive, realizimi i të hyrave nga kjo kategori mbetet i ultë. Vazhdimi i praktikave të tilla mund të nxis edhe obliguesit tjerë t'i shmangen pagesës së qirave. Mos realizimi i të hyrave të planifikuara rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj se do të rishikohen kontratat për qiradhënie dhe do të hartohet një plan masash ku do të përcaktohen afatet kohore shtesë për kryerjen e pagesave dhe përgjegjësit për zbatimin e masave të propozuara në mënyrë që të mbliidhen borxhet e mbetura, si dhe në baza të rregullta të inkasohen borxhet aktuale.



**Çështja 8 - Mos aplikimi i drejtë i tarifave për lejet e ndërtimi - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Komuna me 11.12.2014 kishte kërkuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për shqyrtimin lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës së densitetit prej 2.77€ për m<sup>2</sup>, për lejet e reja. MMPH iu kishte përgjigjur pozitivisht komunës për taksën administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit. Ne kemi testuar gjashtë (6) mostra nga të hyrat e lejeve ndërtimore dhe kemi identifikuar se në gjashtë (6) raste është lëshuar leja e ndërtimit nga drejtoria e urbanizmit, duke faturuar 2.30€/m<sup>2</sup>, sipas rregullores së vjetër. Komuna për gjashtë (6) rastet e testuara ka nënvlërësuar të hyrat në shumë prej 14,396€.
- Rreziku** Mos respektimi i tarifës për lëshimin e lejeve të ndërtimit të shqyrtuar nga MMPH, ka ndikuar në inkasimin e më pak të hyrave për buxhetin e komunës.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të analizoj pse rastet e tilla kanë ndodhur, të bëjë korrigjimet e duhura si dhe të forcoj kontrollet që sigurojnë respektimin e tarifës për lëshimin e lejeve të ndërtimit.

**Çështja 9 - Ngarkesat joadekuate me tarifa dhe lëshimi i lejes para pagesës - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Në procesin e auditimit kemi rishikuar gjashtë (6) mostra lidhur me përllogaritjen e taksës komunale për leje të ndërtimit. Në një mostër identifikua se përllogaritja e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit ishte bërë më tepër për shumën prej 1,188€.
- Në një rast ishte lëshuar leja e ndërtimit nga drejtoria e urbanizmit për ndërtim, pastaj është bërë pagesa për leje të ndërtimit nga ana e aplikuesve. Sipas ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 neni 21 paragrafi 3 theksohet se nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, atëherë organi kompetent e lëshon lejen e ndërtimit.
- Rreziku** Përllogaritja e taksës për leje të ndërtimit më tepër se sa lejohet me rregullore, ndikon në trajtim jo të barabartë dhe dëmtim financiar të operatorit ekonomik dhe lëshimi i lejes së ndërtimit para se të kryhen obligimet nga ana e aplikuesit, rrit rrezikun e inkasimit të mëvonshëm të tarifave.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të siguroj se me rastin e ngarkesës me taksë për leje të ndërtimit të ushtroj kontrole të duhura dhe të zbatoj rregulloren për taksat në lejet ndërtimore, në mënyrë që të mos i dëmtoj financiarisht operatorët ekonomik, dhe se të gjitha taksat për leje ndërtimi paguhen para se të lëshohen lejet.

**3.1.2 Pagat dhe mëditjet**

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 8,774,375€, ndërsa shpenzimet 8,711,706€ apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit, (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për këshilltarët komunal). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Për mostrat e testuara, nuk kemi ndonjë çështje për të raportuar.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### **3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunal**

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal në vitin 2016 ishte 1,120,214€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,060,625€ apo 95%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak, shihet një rritje e performancës prej 8% (në 2015 - realizimi ishte 87%). Për mostrat e testuara, nuk kemi ndonjë çështje për raportim.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### **3.1.4 Subvencionet dhe transferet**

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 381,718€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 375,763€ apo 98%, niveli i njëjtë i shpenzimit (98%) ishte edhe në vitin 2015.

### **Çështja 10 - Mos respektimi i rregullores për ndarjen e subvencioneve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Me datë 23.03.2016, Kryetari i Komunës kishte marr vendim për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 1,500€, për subvencionimin e Shoqatës së Minatorëve të Goleshit, për manifestimin e „Ditës së Minatorëve”. Ne kemi vërejtur se shoqata nuk kishte sjellë raporte kthyesë mbi shpenzimin e mjeteve financiare, ashtu siç kërkohet me rregulloren e brendshme.

**Rreziku** Mungesa e raporteve kthyesë, rrit rrezikun që dhënia e mjeteve të mos ketë arritur vlerën për paranë e dhënë dhe qëllimin e subvencionimit.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se përfituesit e subvencioneve do të raportojnë për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të përfituara në pajtim me kërkesat e rregullores në fuqi .

---

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,534,433€. Prej tyre, në 2016 ishin shpenzuar 3,024,200€ apo në shkallën prej 86% që krahasuar me vitin 2015 (89%) kemi një rënie në shfrytëzim të buxhetit për 3%.

#### Çështja 11 - Inicimi i prokurimeve për punë pa projekte - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Në tri (3) raste komuna nuk kishte bërë hartimin e projektit ekzekutiv për projektet kapitale. Rastet e tilla kanë të bëjë me këto projekte: "Ndërtimi i trotuareve në fshatin Llugaxhi" në vlerë 27,701€, " Zhavorimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Komunën e Lipjanit" në vlerë 42,769€ dhe "Ndërtimi i zonës ekonomike "Parku industrial" në Qylagë të Komunës së Lipjanit" në vlerë 149,877€. Neni 28.10 i Ligjit të Prokurimit Publik, lidhur me specifikimet teknike për kontratat për punë ndër të tjera thekson: "Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit, pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

**Rreziku** Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të siguroj se drejtoria e prokurimit do të marr masat e duhura që para fillimi të secilës procedurë të prokurimit për punë/ndërtim, të zbatoj kërkesat për hartimin e projekteve ekzekutive të ndërtimit.

**Çështja 12 - Pagesa për pozicione të pakompletuara - Prioriteti i lartë**

**E gjetura** Te Kontrata “Ndërtimi i objektit sportiv në fshatin Shalë” të datës 21.10.2011, në vlerë 241,426€, gjatë ekzaminimit fizik kemi vërejtur se tetë (8) pozicione ishin paguar, përderisa nuk ishin të kompletuara sipas paramasës dhe paralogarisë. Pozicionet e pa kryera, por të paguara ishin; mos lyerja e strukturës metalike të kulmit të sallës, e cila ishte me korozion dhe disa pjesë të llamarinës ishin të papërfunduara, mos vendosja e rrjetave mbrojtëse në 15 dritare, vendosja e plastikës në dyert e hyrjes dhe jo e xhamit, mos përfundimi i sistemit të drenazhimit dhe mos vendosja e rrjetave mbrojtëse në trupat ndriçuese. Se pozicionet nuk ishin ekzekutuar në pajtim me kontratën, është pajtuar edhe menaxheri i projektit.

**Rreziku** Mbikëqyrja e dobët e projekteve nga ana e organit mbikëqyrës dhe ekzekutimi i plotë i pagesës për pozicionet e kontraktuara, por të pa përfunduara, rrit rrezikun që projektet të mos jenë në pajtim me standardet ndërtimore dhe të mos jetë arritur vlera për paranë e dhënë.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet vendos kontrollë rigoroze mbi mbikëqyrjen e projekteve në mënyrë që të gjitha pagesat të bëhen në bazë të punëve të përfunduara dhe të kontraktuara.

**Çështja 13 - Kontratat pa zotim të mjeteve - Prioriteti i lartë**

**E gjetura** Kontrata “Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mirenë faza e I-rë” me vlerë 32,611€, kemi vërejtur se ishte nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve.

Në 6 dosje të testuara të tenderëve, kemi identifikuar se deklaratat e nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve financiare është nënshkruar pas inicimit të procedurave të prokurimit.

**Rreziku** Nënshkrimi i kontratës pa zotim të mjeteve dhe nënshkrimi i deklaratave të disponueshmërisë së mjeteve pas inicimit të prokurimit, rrit rrezikun e hyrjes në obligime financiare të komunës, dhe mundësinë që komuna t’u ekspozohet kontesteve gjyqësore.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të procedurave të prokurimit, të nënshkruhet deklarata e disponueshmërisë së mjeteve si dhe zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës.

**3.2 Pasuritë****3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale**

Në PFV komuna kishte paraqitur pasurinë mbi 1,000€ në vlerë 169,119,668€, ndërsa atë nën 1,000€, vlerën 484,013€. Për mostrat e testuara, nuk kemi ndonjë çështje për tu raportuar.

## Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna nuk kishte nxjerrë dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, si kategori dominuese e llogarive të arkëtueshmëve, taksë në ushtrimin e veprimtarisë, qiratë komunal (tokat, lokalet dhe banesat).

#### Çështja 14 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 3,318,916€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë (2,637,029€), taksa në ushtrimin e veprimtarisë në biznes (578,359€), dhe qiraja komunale (103,528€).

Nga 15 mostrat e testuara për tatimin në pronë, kemi vërejtur se 12 obligues tatimor nuk i kishin kryer obligimet ndaj komunës. Obligimi për shfrytëzuesit në total ishte 238,118€.

Nga 6 mostrat e testuara për qiratë komunale të LL/A, kemi vërejtur se 4 obligues nuk i kishin kryer obligimet ndaj komunës. Obligimi për shfrytëzuesit ishte 38,168€.

Ne nuk kemi vërejtur nëse komuna ka marr ndonjë veprim në lidhje me inkasimin e këtyre borxheve.

**Rreziku** Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 637,993€ që janë grumbulluar për vite me radhë. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2017.

---

**Çështja 15 - Obligimet e papaguara - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Është e pakuptimtë ekzistenca e këtyre borxheve të konsiderueshme të papaguara, përderisa 757,608€ janë bartur si të hyra të papshpenzuara në vitin 2017. Këto detyrime kanë të bëjë me investime kapitale 307,862€, mallra dhe shërbime 149,724€, shpenzimet komunale 12,766€, dhe subvencione 11,000€. Po ashtu, komuna kishte obligime në emër të pagave ndaj mësimdhënësve në vlerë prej 156,641€, të cilat nuk ka arritur t'i paguaj me kohë.
- Rreziku** Dështimet për t'i kryer obligimet ndaj punëtorëve arsimor dhe furnitorëve të tjerë, sipas afateve të parapara me rregulloret, rrit rrezikun që planet e shpenzimeve nuk mund të arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar këto obligime në njërën anë, dhe padive gjyqësore ndaj komunës, në anën tjetër.
- Rekomandimi 16** Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, Kryetari duhet të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin për kryerjen e borxheve ndaj furnitorëve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Zbatimi i Rekomandimeve nga viti Paraparak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Nga 12 rekomandime, vetëm 1 është zbatuar plotësisht, 7 ishin në proces dhe 4 të pazbatuar.	
2.5.1 Menaxhimi i Rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se do krijohen procedura formale për menaxhimin e rrezikut për organizatën në mënyrë, të përcaktoj dhe ndërmerr veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike.		Komuna ka listë të rreziqeve, mirëpo nuk kishte bërë monitorim që i ndërlidhë objektivat me rezultatet.	
2.5.2 Kontrolllet Menaxheriale	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.	X		
2.6 Sistemi i Auditimit të	Kryetari duhet edhe më tutje të fuqizoj mekanizmat që rekomandimet		Komiteti i auditimit ka adresuar kërkesën për hartimin e statutit ,	

Brendshëm	e NJAB, të adresohen dhe të siguroj se komiteti i auditimit është vazhdimisht aktiv në shqyrtimin e çështjeve të dala nga auditimi dhe të nxitë përmirësimin e aktiviteteve operative dhe financiare të komunës. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit të hartoj statutin ku specifikohet fushëveprimi dhe objektivat, dhe mbi këtë të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.		ndërsa nuk janë zbatuar rekomandimeve të NJAB nga menaxhmenti.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet brenda kategorive ekonomike, dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat për ekzekutimin maksimal të buxhetit.			X
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen vendosur kontrole të shtuara tek mbikëqyra e projekteve në mënyrë që punimet të kryhen sipas paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar.			X
	Kryetari duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, dhe të ushtrojë më shumë		Është adresuar nënshkrimi i aneks kontratave dhe mbikëqyrja e projekteve, ndërsa nuk janë adresuar mungesa e projekteve	

	kontrolle për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.		dhe pagesat për pozicione të papërfunduar.	
3.4.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të siguroj se do ketë raportim nga ana e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve si dhe subvencionimi në fushën e bujqësisë të bëhet në mënyrë të hapur duke vendosur kritere të qarta.		Janë vendosur kritere në këtë fushë, ndërsa ende mungojnë raportet kthyesë.	
3.5 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Veprime shtesë ka nevojë të ndërmerren për të siguruar se tatimet mbledhen në nivelet e parashikuara dhe verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet me ligj.			X
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se nuk do shfrytëzohet prona komunale pa kontrata valide. Këtë duhet ta rregullojë përmes organizimit të ankandit publik sipas ligjit mbi shfrytëzimin e pronës komunale.			X
	Kryetari duhet të siguroj se para se të lëshohet leja e ndërtimit, fillimisht të kryhen të gjitha obligimet nga ana e aplikuesit të ndërtimit, e pastaj të lëshohet leja e ndërtimit.		Në përgjithësi është adresuar, përjashtimisht një rastë është identifikuar që është lëshuar leja para pagesës së taksës për leje ndërtimi.	
3.6.2 Trajtimi i	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar do procedohen për		Faturat e viti aktual janë paguar	

---

borxheve	pagesë brenda afatit të paraparë me rregullën e thesarit nr.02/2013, si dhe për kontratat që janë nënshkruar nga vitet e kaluara pa zotime të mjeteve të planifikoj buxhet në mënyrë që të kryhen obligimet me kohë. Ne sugjerojmë që me rastin e planifikimeve buxhetore, Kryetari i Komunës duhet ta diskutoj dhe zgjidhë këtë problem me Qeverinë, përkatësisht me Ministrinë e Financave.		me kohë, përderisa kemi bartje të obligimeve të vjetra, sidomos tek punëtorët e arsimit.	
----------	---	--	--	--

## Shtojca IV: Letër konfirmimi



[Komuna e Lipjanit]

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:

I nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyres Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Imri Ahmeti

